

Vendim nr. 77 datë 13.04.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 13.04.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (G) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **GAZMEND RUSI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-2683 (341), datë 05.10.2022 të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi Gazmend Rusi (*kërkuesi*) ka nënshkruar deklaratën noteriale me nr. 169 rep. dhe nr. 70/1 kol., datë 25.01.2007, përmes së cilës ka deklaruar se ka marrë hua nga shtetasi R.P., shumën 70, 000 USD me interes 2% në muaj, për një periudhë njëvjeçare me afat kthimi në datën 31.01.2008. Sipas kësaj deklarate, vlera totale e detyrimit në datën e kthimit të huas është llogaritur në shumën 86,800 USD.

2. Mbështetur në deklaratën e mësipërme, në datën 29.01.2007, shtetasi R.P. i ka kaluar kërkuesit në llogarinë e tij bankare shumën 60,000 USD, ndërsa në datën 03.04.2007 shumën 30,000 USD. Po kështu, sipas të dhënave të llogarisë së kërkuesit pranë Tirana Bank sh.a., rezulton se ai ka transferuar për shtetasin R.P. shumën 27,000 USD në datën 23.07.2007, shumën 10,000 USD në datën 07.01.2008 dhe shumën 27,000 USD në datën 09.09.2008.

3. Në kushtet kur afatet kohore të përcaktuara në deklaratën noteriale me nr. 169 rep. dhe nr. 70/1 kol., datë 25.01.2007 për pagimin e huas kanë kaluar dhe kërkuesi nuk ka kryer veprime për të finalizuar përmbushjen e plotë të detyrimit, shtetasi R.P. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt detyrimin e kërkuesit për kthim shume dhe të interesave ligjorë mbi të.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 10258, datë 30.10.2012, ka vendosur: *“Pranimin pjesërisht të padisë. Detyrimin e të paditurit Gazmend Rusi t’i kthejë paditësit R.P. shumën prej 42,910 USD si detyrim i papërmbyshur nga deklarata noteriale nr. 169 rep. dhe nr. 70 kol., datë 25.01.2007. Detyrimin e të paditurit Gazmend Rusi t’i kthejë paditësit R.P. shumën prej 3,851 USD (deri në datën e relatimit të aktit 02.07.2012) si rezultat i fitimit të munguar nga mosekzekutimi në kohë i detyrimit dhe nga data e 02.07.2012 detyrimi i tij është 3.07 USD në ditë deri ditën e ekzekutimit të vendimit. Rrëzimin për pjesën tjetër të padisë [...]”*. Kundër këtij vendimi, në datën 27.11.2012, kërkuesi ka paraqitur ankim.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2687, datë 19.12.2013, ka vendosur: *“Lënie në fuqi të vendimit nr.10258, datë 30.10.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.”*. Kundër këtij vendimi, në datën 17.01.2014, kërkuesi ka ushtruar rekurs.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-2683 (341), datë 05.10.2022, ka vendosur: *“Prishjen e vendimit nr. 2687, datë 19.12.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues”*, me arsyetimin se vendimi i gjykatës së apelit është marrë në zbatim të gabuar të ligjit dhe, si i tillë, është i cenueshëm, pasi

kjo gjykatë nuk u ka dhënë përgjigje të argumentuar shkaqeve të paraqitura nga pala e paditur në ankimin e saj, për rrjedhojë nuk ka bërë një hetim të plotë e të gjithanshëm të çështjes objekt shqyrtimi brenda shkaqeve të ankimit, sipas përcaktimeve të nenit 14 dhe 465 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

7. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-2683 (341), datë 05.10.2022 të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë. Fillimisht, kërkesa e tij është paraqitur në datën 27.02.2023 dhe pasi është plotësuar, është regjistruar në datën 23.03.2023.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

8.1. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk u ka dhënë përgjigje të argumentuar të gjitha shkaqeve të ngritura në rekurs. Ndonëse përmban palët ndërgjyqëse, ai nuk arsyeton që pala paditëse jeton jashtë vendit, nëse avokati ka qenë prezent dhe se pala e paditur ka qenë në mungesë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka konstatuar dhe nuk ka arsyetuar për çështjet e ligjit që i ka ngritur në të gjitha shkallët e gjyqimit, të cilat merren në shqyrtim kryesisht edhe nëse palët nuk kanë paraqitur më parë mendimet e tyre. Ai nuk ka bërë asnjë interpretim për to, sidomos për sa u përket interesave, të cilat duheshin përlllogaritur sipas vendimit nr. 932, datë 22.06.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si dhe se interesat e kërkuara nga pala tjetër janë shuar për shkak të kalimit të afatit 3-vjeçar, sipas nenit 115, shkronja “dh”, të KPC, veprim që kryhet nga gjykata kryesisht. Arsyetimi i vendimit nuk është i qartë e i kuptueshëm dhe argumentet e pjesës hyrëse nuk janë të lidhura logjikisht me pjesën arsyetuese dhe atë urdhëruese. Ato nuk formojnë një përmbajtje koherente brenda tij, çka bën që përmbajtja dhe arsyetimi i tij të mos kenë harmoni të brendshme. Mungesa e paraqitjes

së shkaqeve të parashtruara në rekurs në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë përbën një të metë të pakapërcyeshme të përmbajtjes së vendimit dhe arsyetimit të gjykatës.

- 8.2. *Parimit të kontradiktoritetit*, pasi vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është marrë në mungesë të kërkuarit, si pasojë e mosdorëzimit të dëftesës së komunikimit nr. 00721/14 prot., pasi ai nuk ndodhej në banesën e tij. Përpjekjet për dorëzimin e aktit të sipërcituar të kërkuarit janë kryer 4 (katër) herë dhe, në vijim, objekti postar është kthyer mbrapsht në sekretarinë gjyqësore të gjykatës. Në këto kushte, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duhet të kishte përsëritur procedurën e dorëzimit të dëftesës së komunikimit dhe të merrte vendim për caktimin e një seance tjetër, brenda një afati të arsyeshëm, me qëllim që kërkuarit t'i jepej mundësia për t'u dëgjuar. Kjo shkelje e bën të cenueshëm vendimin e Gjykatës së Lartë. Mungesa e kërkuarit në gjykim e ka çuar Gjykatën e Lartë në përfundime të gabuara, duke mos i dhënë zgjidhjen e duhur ligjore çështjes, në shkelje të parimit të kontradiktoritetit, sipas të cilit asnjë palë nuk mund të gjykohet pa u dëgjuar ose pa u thirrur në gjykim.
- 8.3. *Së drejtës për akses në gjykatë*, pasi Gjykata e Lartë gjatë shqyrtimit paraprak ka ngritur çështje ligjore, të cilat, në referim të nenit 473/a të KPC-së, duhet të diskutoheshin me palët. Për këtë arsye, kjo gjykatë ka urdhëruar njoftimin e palëve nëpërmjet dëftesës së komunikimit, bashkëlidhur së cilës duhet të ishte vendimi përkatës, sipas të cilit palës së paditur i kërkohet të depozitojë parashtresat e saj për çështjet e ligjit brenda afatit të caktuar. Mosparaqitja nga pala e paditur, si pasojë e mosdorëzimit të dëftesës së komunikimit me vendimin përkatës, të parashtresave me shkrim në lidhje me çështjet ligjore që kërkonin debat në seancë nga ana e palëve në gjykim, e bën procesin të parregullt, duke i mohuar palës së paditur mundësinë e aksesit në Gjykatën e Lartë.
- 8.4. *Parimit të hetimit të plotë e të gjithanshëm*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka përmbushur detyrat e caktuara në KPC, që përbëjnë *condicio sine qua non*, për një proces të rregullt ligjor. Ai nuk është shprehur për pavlefshmërinë e padisë objekt gjykimi, veprim ky që kryhet *ex-officio* nga gjykata e çdo shkalle, edhe nëse nuk është kërkuar nga palët, si dhe nuk ka konstatuar, analizuar e pasqyruar në pjesën arsyetuese të vendimit faktin që padia është me të meta, në kuptim të nenit 115, shkronja "dh", të

Kodit Civil, sipas të cilit paditësi nuk legjitimohet për të kërkuar interesa nëse kanë kaluar 3 vjet nga e drejta për t'i kërkuar ato nëpërmjet gjykatës. Duke mos konstatuar këtë shkelje ligjore, Kolegji Civil nuk ka caktuar asnjë detyrë për gjykatën e apelit për korrigjimin e kësaj shkeljeje të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nëpërmjet rigjyimit, çka i ka shkaktuar kërkuarit dëm financiar.

8.5. *Parimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka shkelur ligjin procedural, për arsyet e cituara më sipër. Kjo shkelje e ligjit ka sjellë si pasojë mungesën e aksesit në gjykatë të kërkuarit dhe pamundësinë për t'u dëgjuar përpara gjykatës në ditën e zhvillimit të seancës gjyqësore, duke penalizuar dhe dëmtuar padrejtësisht interesat e tij pasurorë. Respektimi dhe zbatimi i normave kushtetuese është i pandashëm me respektimin e zbatimin e ligjit. Kushtetutshmëria dhe ligjshmëria përbëjnë një tërësi të vetme të pandashme dhe gjykatat në veprimtarinë e tyre detyrohen të zbatojnë ligjin. Për sa më sipër, shkelja e ligjit nga ana e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë do të thotë që ai ka shkelur Kushtetutën dhe nuk ka zhvilluar një proces të drejtë dhe të rregullt ligjor.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuarit

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërës prej tyre që kërkuksi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykit kushtetues.

11. Kolegji vlerëson se kërkuksi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatën Kushtetuese (*shih vendimin nr. 12, datë 24.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron kjo Gjykatë, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit (*shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ajo mund të kërkohe vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtëjshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 4, datë 22.02.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuksi ka kundërshtuar vendimin nr. 00-2022-2683 (341), datë 05.10.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur prishjen e vendimit nr. 2687, datë 19.12.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe e ka dërguar çështjen për rishqyrtim në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

15. Për sa i përket këtij vendimi, Kolegji vlerëson se vendimi i kundërshtuar objekt ankimi kushtetues individual, nuk ka vendosur në mënyrë përfundimtare për çështjen. Procesi gjyqësor për objektin e gjykit vazhdon ende të gjykohe në themel nga gjykatat e juridiksionit të

zakonshëm. Në këto kushte, vendimi nr. 00-2022-2683 (341), datë 05.10.2022 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk mund të konsiderohet përfundimtar në kuptim të vendimit gjyqësor për të cilin janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi kërkuesi i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rishqyrtimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë.

16. Mbështetur në standardet e mësipërme kushtetuese dhe referuar rrethanave të rastit në shqyrtim, në kushtet kur çështja është kthyer për rishqyrtim dhe procedurat gjyqësore për shqyrtimin e saj në themel nuk kanë përfunduar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, Kolegji çmon se kërkesa nuk e plotëson kriterin paraprak të shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion, të parashikuar nga nenet 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000. Në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

17. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.